

FITIM RIFATI: KOSOVA GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE
1914-1918, Instituti i Historisë-Prishtinë, **Prishtinë: 2019, 410 f.**

Kolanës së studimeve albanologjike iu shtua edhe botimi *Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918*, Instituti i Historisë-Prishtinë, 2019 me autor studiuesin dr.Fitim Rifati. Kjo monografi është konceptuar në gjashtë kapituj.

Në kapitullin e parë autori ka trajtuar situatën politike të Kosovës në prag të Luftës së Parë Botërore (1913-1914). Kjo i shërben lexuesit për ta njohur atë me kontekstin e zhvillimeve historike. Ai ka trajtuar hollësisht gjendjen e kësaj treve nën administrimin serbo-malazez nga vitet e Luftërave Ballkanike deri në qershor të 1914-ës. Në këtë kapitull analizohen politikat antishqiptare të fqinjëve ballkanikë ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës dhe përpjekjet e saj për të organizuar një kryengritje të armatosur. Autori sjell fakte dhe dëshmi interesante, të cilat flasin për numrin e viktimave dhe të shpërngulurve drejt Perandorisë Osmane. Represioni i autoriteteve serbo-malazeze konstatohet jo vetëm në aspektin e eliminimit fizik dhe dëbimit të shqiptarëve me dhunë, por edhe në aspektin ekonomik, fiskal, demografik dhe arsimor.

Në kapitullin e dytë autori ka trajtuar situatën politike dhe zhvillimet në fazën e parë të luftës (28 qershor 1914 - shtator 1915). Ky kapitull hapet me një vështrim historik mbi rrethanat ndërkombëtare në prag të LPB-së; mbi blloqet ndërluftuese dhe interesat e tyre, të cilat do të përfshijnë në vorbullën e luftës edhe territorin shqiptar, duke e vendosur popullsinë dhe elitën politiko-patriotike në dilemë se me cilën palë duhej të pozicionoheshin. Ai trajton me kujdes qëndrimin e shqiptarëve të Kosovës në raport me rrethanat e reja dhe reagimin serbo-malazez ndaj Kosovës në korrik-dhjetor të 1914-ës. Këto të fundit i trembeshin faktit se paria e Kosovës e dëshpëruar nga politikat antishqiptare do të hidhej lehtësisht me ushtrinë austro-hungareze. Serbia dhe Mali i Zi do të marrin masa për ta frenuar një veprim të tillë. Në funksion të këtij plani këto dy shtete do të përdorin jo vetëm forcën, por edhe kompromentimin e disa shqiptarëve.

Rreshtimi i shqiptarëve përkrah ushtrisë austro-hungareze ishte një veprim i drejtë dhe i imponuar nga mungesa e alternativave. Por zelli me të cilin ata kërkonin organizimin e një aksioni kundër forcave serbo-malazeze do t'i ndajë ata në dy pjesë. Një grupim ishte më i ndërgjegjshëm se një sulm ndaj tyre mund të shkaktonte mësymjen e forcave serbo-malazeze që ishin më të shumta në numër. Ndërsa, një grupim tjetër ku bënte pjesë Hasan Prishtina ishte për

ndërmarrjen e një sulmi të menjëhershëm. Mirëpo konsequencat që mund të rridhnin për popullsinë shqiptare ngrinin shumë pikëpyetje.

Në kapitullin e tretë autori ka trajtuar pushtimin bullgar dhe austro-hungarez të Kosovës dhe ndarjen e saj në aspektin administrativ nga këto dy shtete (tetor 1915 – prill 1916). Ky kapitull përbën një rëndësi më vete për faktin se autori ka trajtuar me kujdes duke u mbështetur në një bazë të pasur burimore probleme të rëndësishme në fazën e parë të këtij pushtimi. Kështu, çështje të tilla si tërheqja e ushtrisë serbe nëpërmjet territorit shqiptar; vrasja e Isa Boletinit në Podgoricë dhe përplasja austro-bullgare lidhur me caktimin e kufirit të zonave të pushtimit janë analizuar saktë dhe në mënyrë të detajuar.

Në kapitullin e katërt për shkak të intensitetit autori ka vendosur të trajtojë veçmas viset e Kosovës nën pushtimin dhe administrimin e Austro-Hungarisë në vitet 1915-1918. Ai sjell një informacion të bollshëm lidhur me organizimin dhe funksionimin e administratës austro-hungareze, e cila përbën një trashëgimi të mirë për popullsinë shqiptare në aspektin politik. Por, ai nuk lë pa trajtuar edhe rekrutimin e dhunshëm jo vetëm nga austro-hungarezët, por edhe nga ndonjë aleat i tyre, siç ishte Perandoria Osmane. Ky fenomen përbente një rrezik eminent për popullsinë shqiptare në aspektin demografik. Prandaj drejtuesit civilë dhe ushtarakë austro-hungarezë do përpiqen ta minimizojnë një aksion të tillë.

Raportet politiko-shoqërore të popullsisë shqiptare në Kosovë me administratën austro-hungareze tregojnë se ai nuk ka qenë konstant. Ai ka ndryshuar në varësi të rrethanave që impononte lufta. Kjo do të evidentohet qartë në sythin pasues i cili trajton çështjen e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë në barometrin diplomatik dhe ushtarak austro-hungarez. Këtu del saktë politika e Vjenës lidhur me këtë problem. Autori konstaton me të drejtë se tek elita politike dhe ushtarake austro-hungareze ekzistonin disa pikëpamje, duke nënvizuar se vektori proshqiptar varionte edhe nga origjina e politikanëve, diplomatëve dhe ushtarakëve austro-hungarezë, disa prej të cilëve ishin sllavë. Konfliktet e armatosura, burgosja dhe internimi i popullsisë shqiptare nga administrata austro-hungareze nuk ishin raste të rralla. Kjo sidomos kur ata nuk i bindeshin.

Pozita ekonomike e Kosovës nën pushtimin austro-hungarez përbën një nënçështje më vete dhe trajton disa aspekte. Kjo për mendimin tim përbën një pikë delikate sepse për shkak të kushteve të luftës popullsia shqiptare do t'i nënshtrohet politikave rekuizive. Sidoqoftë marrëdhëniet tregtare dhe qarkullimi monetar vazhdoi të funksiononte sipas diktatit të administratës.

Kontributi më pozitiv i Austro-Hungarisë është politika arsimore, e cila kishte si qëllim emancipimin kombëtar dhe kulturor të popullsisë shqiptare. Kjo do të reflektohet me hapjen e një numri të konsiderueshëm institucionesh, financimin e botimit e teksteve shkollore.

Në kapitullin e pestë ashtu si në kapitullin pararendës për shkak të intensitetit të zhvillimeve autori ka vendosur të trajtojë veçmas viset e Kosovës nën pushtimin dhe administrimin e Mbretërisë Bullgare në vitet 1915-1918. Ai trajton me kujdes politikën e administratës ushtarake bullgare ndaj popullsisë shqiptare, e cila nuk mund të thuhet se ishte po aq miqësore sa ajo austro-hungareze.

Menjëherë pas vendosjes së kontrollit ushtarak u morën masa për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë. Kjo do t'i shërbente autoriteteve bullgare për rekrutimin e shqiptarëve në radhët e ushtrisë. Një masë e tillë u shoqërua me incidente, represion dhe konflikte, për shkak se popullsia vendase, nuk dëshironte të mobilizohej.

Pakënaqësia e popullsisë shqiptare ndaj administratës ushtarake bullgare bëri që kjo e fundit të merrte një sërë masash. Burgosja dhe internimi ishte diçka e zakonshme, e cila synonte minimizimin e revoltës.

Në aspektin ekonomik edhe bullgarët do të ndërmarrin një sërë politikash fiskale dhe rekuizuese për nevojat e luftës. Puna e detyruar, diskriminimi kulturor dhe arsimor bullgar do të ngjallin tek shqiptarët shpirtin e revoltës.

Në kapitullin e gjashtë autori trajton tërheqjen e ushtrisë austro-hungareze dhe bullgare nga territori i Kosovës dhe ripushtimin e saj nga ushtria serbe. Ky kapitull është dhe epilogu i kësaj monografie dhe pasqyron rrethanat politike-shoqërore në Kosovë në përfundim të luftës.

Monografia mbyllet me një shtojcë dokumentare dhe fotografike.

Në tërësi ajo përbën një kontribut të vyer historiografik, duke plotësuar trajtimin e viseve shqiptare të Kosovës gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore.

Hasan BELLO